

Vendim nr. 289 datë 27.11.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marjana Semini, Anëtare
Marsida Xhaferllari, Anëtare

në datën 27.11.2024 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 11 (G) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: GAZMIR ZENELI, përfaqësuar nga avokat Neshet Ngucaj, me akt përfaqësimi.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-1125, datë 16.04.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 31, 33, shkronja “d”, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 118, datë 19.07.2000, ka deklaruar fajtor të pandehurin Fatmir Zeneli për veprat penale të vrasjes me paramendim, vrasjes me dashje, vrasjes me dashje në tentativë, plagosjes së rëndë me dashje dhe mbajtjes

pa leje të armëve luftarake, duke e dënuar në bashkim të dënimeve me 25 vjet burgim. Vendimi është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Vlorë, e cila, me vendimin nr. 148, datë 26.09.2000, e ka dënuar të pandehurin me burgim të përjetshëm. Ndërsa Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 26, datë 17.01.2001, ka vendosur mospranimin e rekursit të të pandehurit.

2. Gjykimi është zhvilluar në mungesë të të pandehurit në të tria shkallët e gjykimit. Interesat e tij janë mbrojtur prej avokatit të zgjedhur nga familjarët.

3. Në vitin 2015 kërkuesi Gazmir Zeneli është ekstraduar nga shteti grek dhe iu është dorëzuar autoriteteve shqiptare mbi bazën e urdhrit të ekzekutimit për dënimin e dhënë sipas vendimit penal përfundimtar të mësipërm dhe ka filluar vuajtjen e dënimit.

4. Kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), me të cilin kundërshtonte procesin penal në ngarkim të tij. Gjykata ka marrë në shqyrtim pretendimet e tij dhe me vendimin nr. 40, datë 06.07.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesës.

5. Në vijim, kërkuesi ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë kërkesë për lirim nga burgu, me pretendimin se vendimi penal i dënimit nuk ishte dhënë ndaj tij, për rrjedhojë, ekzekutimi i atij vendimi kishte gabim në identitet. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 9, datë 30.01.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur apel, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 396, datë 05.06.2018, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1125, datë 16.04.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

6. Në datën 06.09.2024 kërkuesi, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Ankimi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000 dhe është regjistruar në datën 20.09.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar *e drejta për një proces të rregull ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

7.1. *E drejta për t'u dëgjuar përpara se të gjykohet*, e garantuar nga neni 33 i Kushtetutës, pasi procesi penal i përmbyllur me vendimin e vitit 2001 të Gjykatës së Lartë është zhvilluar në mungesë, ndërsa kërkuesi është ndaluar me qëllim ekstradimit për të vuajtur dënimin për llogari të dikujt tjetër dhe nuk ka marrë dijeni për këtë proces penal. Ai sapo ka ardhur në Shqipëri i ka njoftuar autoritetet, por vazhdon të vuajë dënimin për llogari të një personi tjetër.

7.2. *Garancitë procedurale të personit të arrestuar*, të parashikuara nga neni 31 i Kushtetutës, pasi organi i prokurorisë në procedimin penal të vitit 1997 nuk ka zbatuar rregullat procedurale të verifikimit të personit, duke mosadministruar certifikatën që lidh të pandehurin Fatmir Zeneli me kërkuesi Gazmir Zeneli. Për këtë arsye, edhe vendimi për caktimin e masës së sigurimit është i pavlefshëm, ndërsa ndalimi në shtetin grek ka qenë arbitrar dhe në kundërshtim me ligjin, pasi kërkuesi nuk ka asgjë të përbashkët me personin e dënuar.

7.3. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi penal i dënimit i dhënë nga gjykata e shkallës së parë është vetëm tre faqe dhe i paarsyetuar. Edhe vendimi i gjykatës së apelit që ka lënë në fuqi atë vendim është, gjithashtu, i paarsyetuar. Ndërsa Gjykata e Lartë nuk ka pranuar të shqyrtojë rekursin dhe rrjedhimisht nuk marrë në analizë asnjë nga pretendimet e mbrojtësit të kërkuesit për shkelje të të drejtave gjatë hetimit, të garantuara nga Kodi i Procedurës Penale (KPP) dhe Kushtetuta. Po kështu, gjykatat e faktit në procesin që ka vendosur rrëzimin e kërkesës për lirim, për shkak të gabimit në identitet, nuk kanë argumentuar konkluzionin me prova sipas ligjit, ndërsa Gjykata e Lartë nuk ka pranuar rekursin me argumentin se nuk ekziston asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së, por pa dhënë arsytim.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton

mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

10. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në vështrim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi kundërshton vendimet gjyqësore të dhëna në procedimin penal ndaj tij, për rrjedhje justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

11. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm. Për pasojë, ai nuk ka mjete të tjera juridike në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

12. Për sa i takon afatit, Kolegji vëren se për ankimet kushtetuese individuale të paraqitura pas datës 01.03.2017, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenit 86, pika 3, të ligjit nr. 99/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577/2000”, afati është shkurtuar nga 2 vjet në 4 muaj. Lidhur me llogaritjen e afatit, Gjykata është shprehur se kur kundërshtohen vendimet e Gjykatës së Lartë, ai fillon nga data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se në përmbajtjen e ankimit kushtetues individual kërkuesi ka kundërshtuar edhe procesin gjyqësor të themelit, në përfundim të të cilit është dënuar me burgim të përjetshëm. Procesi gjyqësor është përmbyllur me vendimin e datës 17.01.2001 të Gjykatës së Lartë, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 06.09.2024, pra pas 23 vjetëve. Ndërkohë, kërkuesi ka paraqitur kërkesë për rishikimin e vendimit penal të dënimit. Kërkesa është rrëzuar nga gjykatat e zakonshme dhe procesi gjyqësor për shqyrtimin e saj është përmbyllur me vendimin e datës 05.03.2024 të Gjykatës së Lartë. Për rrjedhje, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuesit që lidhen me procesin gjyqësor të themelit janë paraqitur haptazi jashtë afatit ligjor, ndaj nuk mund të merren në shqyrtim *ratione temporis*.

14. Për sa u përket pretendimeve në lidhje me procesin, në të cilin është rrëzuar kërkesa për lirim nga burgu, Kolegji vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë, i kundërshtuar nga kërkuesi, mban datën 16.04.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual, siç u evidentua edhe më lart, është paraqitur në datën 06.09.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

15. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji konstaton se kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Sipas tij, gjykatat e faktit kanë arritur në përfundimin se kërkuesi dhe i dënuari janë i njëjti person edhe pse nuk ka një dokument që ta vërtetojë këtë, pa mbajtur në konsideratë faktin se disa nga gjeneralitetet përkatëse ndryshojnë. Po kështu, sipas kërkuesit, gjykata e shkallës së parë i referohet vetëm gjendjes civile për të arritur në konkluzionin se i dënuari dhe kërkuesi janë i njëjti person, ndërsa Gjykata e Lartë nuk ka pranuar të shqyrtojë rekursin me argumentin se nuk ekziston asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së, por pa dhënë arsytim.

16. Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimit gjyqësor si një detyrim i sanksionuar në nenin 142 të Kushtetutës dhe një garanci për procesin e rregullt ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe në funksion të njëra-tjetrës (*shih vendimet nr. 13 datë 21.03.2023; nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 23, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka pohuar se detyrimi për arsytim nuk mund të kuptohet sikur kërkohet një përgjigje e detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 11, datë 16.04.2018; nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, arsytimi i kufizuar i vendimit të mospranimit të rekursit nga Gjykata e Lartë, nuk e cenon procesin e rregullt ligjor. Kjo formë arsytimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit, nga ana e kolegjeve të saj, gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 21, datë 16.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin konkret, Kolegji vëren se vendimet gjyqësore të dhëna në procesin ku është shqyrtuar kërkesa për lirimin nga burgu nuk rezultojnë të jenë alogjike, të kenë kundërthënie ose të mos kenë pasqyruar në mënyrë të mjaftueshme argumentet në mbështetje të përfundimit të shprehur në dispozitiv. Gjykatat e faktit kanë analizuar të dhënat e çështjes dhe provat e shqyrtuara, duke nxjerrë përfundimin se kërkuesi Gazmir Zeneli ishte i njëjti person me të dënuarin Fatmir Zeneli. Në këtë pikë, Kolegji evidenton se edhe Gjykata kur ka shqyrtuar më parë ankimin kushtetues individual të kërkuesit, të paraqitur pas ekstradimitit të tij, ka vënë në dukje se ai njihet me dy emra: Fatmir dhe Gazmir Zeneli (*shih vendimin nr. 40, datë 06.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Kolegji vëren se edhe vendimi i Gjykatës

së Lartë ka përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në përputhje me kompetencat e tij ligjore, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e paraqitura në rekurs i ka dhënë përgjigje kërkuarit lidhur me to, në rastin konkret, se nuk janë të tilla nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së. Për rrjedhojë, vendimet e kundërshtuara rezultojnë në përputhje me standardet kushtetuese, ndaj pretendimi i tij në këtë drejtim është haptazi i pabazuar.

18. Si përfundim, bazuar në arsyetimin e mësipërm, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk i plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “ç” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.